

# NE E FORCOJMË

Ne  
ndjehemi të  
rëndësishëm...

...sepse mund të  
shprehim lirshëm atë që  
mendojmë  
dhe...

...mund të zgjedhim  
atë  
që na pëlqen!



# DEMOKRACINË

# DEMOKRACIA PËR QYTETARËT


ERMAL (13), ERJON (13), EDONIS (14), ENDI (13), RRON (13), VJOLLCA (14)

**Ne jemi gjashtë nxënës të klases 8/1 dhe kemi bërë një intervistë me qytetarë të PRISHTINËS.**


Ne kemi intervistuar gjashtë persona dhe kemi marrë përgjigje të ndryshme dhe shumë të rëndësishme për ne. Shumica e përgjigjeve kanë qenë: të respektohet ligji, vota e lirë, të drejtat dhe përgjegjësitë e qyte-

tarëve kështu me radhë. Ne gjithashtu morëm mendime të tjera si: të jemi aktiv, transparent, të kërkohen të drejtat të cilat garantoohen me ligj.


Pas intervistës, kemi marrë mendime të ndryshme që na kanë bërë të mendojmë për ligjin që duhet të jetë i barabartë për të gjithë, për votën dhe arsimimin.




Të jemi të sinqertë dhe punojmë mirë për të ardhmën e qytetarëve.



Një përgjigje e shpeshtë ishte respektimi i ligjit dhe drejta e votës.



Për demokraci të mirë qytetarët duhet të arsimohen dhe respektojnë ligjin.



Çka duhet një qytetar të bëjë për demokraci të mirë? Cilat janë përgjegjësitë e qytetarit?

# ZGJEDHJET

ARDITA(16), ANIS(14), DRIN(13)FITIM(14), MALSORE(14)VALDRIN(13)

## Qëllimi i zgjedhjeve

Zgjedhjet janë element shumë i rëndësishëm për një vend demokratik, sepse përmes votës ne ndërtojmë të ardhmen e vendit tonë.

Çdo njëri mund të kryej procesin e zgjedhjes prej moshës 18-vjeqare. Është me rëndësi të cekim se një individ ka të drejtë të votojë vetëm një herë dhe vetëm një parti politike. Vota duhet të jetë e fshehtë.

Zgjedhjet ndahen në: zgjedhje lokale dhe qendrore. Zgjedhjet lokale mbahen në nivel të komunave, ndërsa zgjedhjet qendrore mbahen në tërë shtetin.

Pas luftës zgjedhjet demokratike të para në vendin tonë u mbajtën në vitin 2001.

A të votoj apo mos të votoj?  
Në demokraci secili qytetar duhet të votojë!



Vota jote është ardhmja e vendit!




Në demokraci gjithësecili vlen

A do të më votosh mua?



Nuk është demokraci nëse vota imponohet

Le të fitoj më i miri.



Për një të ardhme sa më të mirë



Anis, Malsore, Drin, Valdrin, Ardita, Fitim

## KUVENDI I KOSOVËS

RION(13), SHKUMBIN (13) BLEON(13) MEDINA(13), SHKURTA (13), ARJETA (13)



### Të shkruajmë për kuvendin.

Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë. Kuvendi është një vend ku miratohen ligjet e Republikës së Kosovës. Kuvendi është në kuadër të pushtetit legjislativ sepse miraton ligje.

Tri funksionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë: miraton ligje, mbikqyrë punën e qeverisë, përfaqson popullin. Deputetët i zgjedh elektorati (populli). Të drejtë vote kanë të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeqare. Detyra e deputetëve të Kosovës është t'i përfaqësoj kërkesat tona në Kuvend. Deputetët kanë mandat 4 vjeçarë, kurse Presidenti ka mandat 5 vjeçarë. Kuvendi i Kosovës përbëhet edhe prej Kryeministrit, Minsitrave dhe Zëvendës Ministrave. Kuvendi po ashtu miraton buxhetin e Republikës së Kosovës. Kuvendi përbëhet prej komisioneve të ndryshme si p.sh.: komisioni për kulturë, sport, arsim, shkencë, dhe po ashtu për teknologji, ekonomi etj.

Ligjet që miratohen në Kuvend kanë ndikim te populli ynë. Ligjet qe miratohen per arsim ndikojnë drejtpërdrejt te nxënësit si p.sh. Mësimi tërëditorë ka pasur ndikim të mirë tek ne nxënësit. Kuvendi funksionon në bazë të projektligjëve. Projektligjet kanë të drejtë të propozohen nga qeveria, deputetët dhe nga me së paku 10,000 qytetarë.

Kuvendi i trajton të gjithë njëzëit të barabartë pa dallim

feje, gjinie, race apo identiteti.

Po ashtu, Kuvendi e zgjedh presidentin e vendit.

Ne jemi të lumtur që kemi marrë pjesë në këtë punëtori dhe kemi mësuar shumë gjëra për kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kuvendi është shtëpia e popullit dhe në kuvend merren vendime të rëndësishme për popullin.



Prandaj ne do të jemi të kujdeshëm për kënd të votojmë në të ardhmën.

Ne jemi ardhmëria e vendit prandaj duam të jemi të mirë për vendin tonë.



### Ne jemi pjesë e demokracisë

Në nxënësit jemi pjesë e demokracisë, dhe të gjithë jemi të barabartë. Nëse punojmë së bashku kemi më shumë fuqi. Ne duhet ta respektojmë njëri tjetrin dhe të respektojmë mendimin e të tjerëve sepse kjo është pjesë e demokracisë.



Ne bashkëpunojmë me njëri-tjetrin



Bashkimi bënë fuqinë!

Ne jemi shumë të lumtur.



## NDARJA E PUSHTETIT

ERONA (13), TAULANT(14), ERMAL(13), BEKIM(14), ERBLINA(13), FITORE(14)



Ilustrimi i ndarjes së pushtetit të Republikës së Kosovës.

Ne e dimë se Kosova është një shtet demokratik. Fjala demokraci do të thotë që qeverisë shumica e popullit, andaj në shtet demokratike kemi edhe ndarjen e pushtetit. Në rast që nuk do të kemi ndarjen e pushtetit ai shtet do të ishte shtet monarkik ose ditaktorial. Në Kosovë ndarja e pushtetit ndahet në mes të: Qeverisë, Kuvendit dhe Gjykatës. Në kabinetin qeveritar punojnë: kryeministri, ministri dhe zv.ministri. Në qeveri zgjedhet partia që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhje. Qeveria zakonisht formohet nga disa parti dhe jo nga një parti e vetme. Pushteti tjetër që është kuvendi përbëhet nga 120 deputet. Deputetët mund të jenë të një partie politike ose mund të jenë kandidat të pavarur. Në gjykatë punojnë: gjykatësit, prokurorët dhe avokatët të cilët vendosin drejtësi në vend në bazë të kushtetutës. Këto tri pushtete punojnë të pavarura por janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Qeveria e propozon një ligj, kuvendi e pranon, dhe në fund në rast të kërkesës së deputetëve Gjykata Kushtetuese e shikon se a është në pajtim me kushtetutën apo jo. Ne e kuptojmë ndarjen e pushtetit në këtë mënyrë: Qeveria e propozon ligjin të mos hedhjes të mbeturinave në tokë dhe kudo në hapsirë, kuvendi e pranon këtë propozim të qeverisë dhe në fund gjykata pajtohet me këtë vendim, sepse nuk ka shkelje të kus-

hetutes. Ne vendosëm ta shkruajm këtë artikull për ndarjen e pushtetit dhe demokracisë sepse gjithqka që ndodh me ndarjen e pushtetit dhe demokracinë ndërlidhet direkt me ne. Ne duhet të dimë më shumë për ndarjen e pushtetit dhe demokracinë sepse edhe neve do të na vijë koha që të votojmë për deputet dhe nuk do të dimë të zgjedhim deputetin e duhur, për ne, si dhe partinë që do të jetë në qeverisje e vendit.



### Historiku mbi ndarjen e pushtetit në Kosovë prej vitit 1999 deri në kohën e sotme

Në këtë artikull do të mësoni më shumë për ndarjen e pushtetit prej viteve 1999 në përfundim të luftës që ka ndodhur në Kosovë deri në ditët e sotme ku Kosova është shtet i pavarur.


Në këtë artikull ne kemi paraqitur sesi në fillim ndarja e pushtetit është mbikëqyrur nga OKB-ja, më pas janë bërë bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe pasi që është nënshkruar pako e Ahtisarit, Kosova është shpallur shtet i pavarur dhe demokratik dhe tani ndarja e pushtetit udhëheqët nga vendorët.



Ndarja e pushtetit në mbikëqyrjen e OKB-së



Ndarja e pushtetit ne vitet 1999 në Kosovë.



Bisedimet ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe Serbisë



Pakoja e Ahtisarit



Ndarja e pushtetit nën mbikëqyrjen e vendorëve

